

Datë: 21 Maj, 2019

## KONKLUZIONE

### NGA

### KËSHILLIMI PUBLIK I DOKUMENTIT

## “DRAFT VENDIMI PËR RREGULLIMIN E TARIFAVE ME SHUMICË DHE PAKICË TË ROAMINGUT SI DHE ATO TË TERMINIMIT TË THIRRJEVE MOBILE ME REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Dokumenti ‘Vendimi për Rregullimin e tarifave me shumicë dhe pakicë të roamingut si dhe ato të terminimit të thirrjeve mobile me Republikën e Shqipërisë’ është përgatitur mbështetur në nenin 1, nenin 3, paragrafi 1), nenin 9 paragrafi 1), neni 64 paragrafi 1) dhe nenit 79, paragrafët 1) dhe 2), të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*); Nenit 1, nenit 3 dhe nenit 5 të Marrëveshjes për heqjen e çmimeve të shërbimeve roaming për rrjetet publike të komunikimeve elektronike të lëvizshme ndërmjet Ministrive përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike të: Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë të datës 26 Nëntor 2018; Rregulloren e BE-së Nr. 531/2012 (BE) mbi “Shërbimin roaming në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme” që është amenduar në Rregulloren e BE-së Nr. 2015/2120 dhe në Rregulloren Nr. 2017/920 në lidhje me rregullat për tregun me shumicë të roaming, të njëjtë si në shtëpi “roaming like at home-RLAH”; Rregulloren implementuese të Komisionit (BE) nr. 2016/2286, e cila rregullon politikat e përdorimit të ndershëm/drejtë; dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*).

Sipas Vendimit Nr. 1338<sup>1</sup> (Ref. ARKEP Nr. Prot. 024/B/18) të datës 19 Mars 2019, ARKEP ka miratuar fillimin e procedurës së Konsultimit Publik të dokumentit të referuar më lartë nga data; **19 Mars 2019** deri më datë; **15 Prill 2019**.

Gjatë periudhës së Konsultimit Publik, komente kanë dërguar operatorët si në vijim:

- 1) **Komentet e Telekom i Kosovës sh.a.** - janë dërguar më datë 15 Prill 2019 (Ref. ARKEP Nr. Prot.245/2/19),
- 2) **Komentet e IPKO-së** - janë dërguar më datë 15 Prill 2019 (Ref. ARKEP Nr. Prot.246/2/19),

Gjithashtu paraprakisht ARKEP ka realizuar takime me operatorët më datë 08 Maj 2019, ku janë diskutuar komentet e dërguara.

Bordi i Autoritetit pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga operatorët, në mbledhjen e 40-të me radhë të mbajtur më datë 11 Maj 2019 ka miratuar dokumentin '**Vendimi për Rregullimin e tarifave me shumicë dhe pakicë të roamingut si dhe ato të terminimit të thirrjeve mobile me Republikën e Shqipërisë**' së bashku me përgjigjet/qëndrimet e ARKEP ndaj komenteve të dërguara, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në tabelat si në vijim (Shtojcat I dhe II).

Dokumenti final së bashku me përgjigjet e ARKEP publikohen në web faqen: [www.arkep-rks.org](http://www.arkep-rks.org).

---

<sup>1</sup> <http://arkep-rks.org/?cid=1,13,1135>

## Përgjigjet e ARKEP ndaj komenteve të operatorit 'Telekomi i Kosovës'

N°	Draft Vendimi i ARKEP	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
1	Koment i përgjithshëm	<p>Për shkak të afatit tepër të shkurtër, kërkesës shumë komplekse që involvon përfshirje të shumë sistemeve dhe relacioneve në Telekom dhe në raport me konkurrencën, Monaco Telecom dhe Partnerët roaming të Shqiperisë, kërkohet rishikimi i aplikimit të afatit të parë 1 korrik 2019 dhe shtyerja eventuale pas sezonës së verës.</p> <p>Të shikohet mundësia që teksti i vendimit të përjashtojë në mënyrë eksplicite nevojën për të rregulluar tarifat në planet dhe ofertat ekzistuese tarifore. Synim i yni është që pas sezonit të verës në treg të ofrojmë plane të reja sipas rregullave në fjalë.</p>	Neni 1 i Marrëveshjes ka përcaktuar datën 15 Qershor 2019 për fillimin e zbatimit të regjimit të ri të roamingut dhe si rrjedhojë, kjo datë është e detyrueshme.
2	Paragrafi 2), pika b)	Mos është me mirë që rregullimi të vlejë për krejt trafikun, pa i veçuar thirrjet që janë të lidhura me roaming. Kështu, sic është lene, zbatimi mund të jetë i komplikuar.	Marrëveshja regjionale e roamingut rregullon vetëm tarifat e terminimit të lidhura me thirrjet e origjinuara dhe terminuara në roaming. Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me rregullim minimal, atëherë ju mbetet operatoreve që të vendosin nëse dëshirojnë që tarifa të zbatohet për të gjithë trafikun.
3	Paragrafi 3, pika a):	A është e domosdoshme oferta referente? marrëveshjet roaming janë të standardizuara nga GSMA, dhe nuk është praktike refuzimi i kërkesës për roaming. për më tepër, aktualisht, telekomi ka roaming me të gjithë operatorët e	Operatorët janë të obliguar që të përgatisin dhe publikojnë ofertën referente. Meqenese nuk janë përcaktuar formatet, atëherë mund të përdoren edhe format e standardizuara si ato

N°	Draft Vendimi i ARKEP	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
		shqiperise.	te GSMA.  Për të qenë në përputhje me marrëveshjen rajonale të roamingut, fshihen nenparagrafet a), b), d) dhe e) te paragrafit 3 dhe shtohet paragrafi qe ka te beje me zgjidhjen e mosmarrveshjeve.
4	Paragrafi 3, pika c)	Gjithashtu, qasja me shumice roaming eshte e rregulluar me marreveshje roaming, tekst i standard i GSMA. formulimi per qasje ne kete paragraf jep nje zgjerim te panevojshem dhe tejet te pergjithesuar. rekomandohet qe qasja ti referohet dokumenteve standarde te GSMA, si zevendesim.	Shih komentin me larte.
5	Paragrafi 3, pika d:  “Rregullat për tarifat me shumicë të të shërbimeve të rregulluara të roamingut të përcaktuara në këtë Vendim do të zbatohen për sigurimin e qasjes në të gjithë komponentët e qasjes me shumicë roaming të përmendur në paragrafin 3 më sipër, përveç nëse të dy palët në marrëveshjen e roamingut me shumicë shprehimisht bien dakort që çdo tarifë maksimale e roaming me shumicë që rezulton nga zbatimi i marrvëeshjes nuk shtë objekt i tarifave maksimale	Spo kuptohet qarte? te riformulohet nese eshte e mundur.	Riformulohet paragrafi 3, pika d) si ne vijim:  “Rregullat për tarifat me shumicë të shërbimeve të rregulluara të roamingut të përcaktuara në këtë Vendim duhet të zbatohen për ofrimin e qasjes në të gjithë komponentët e qasjes me shumicë roaming të përmendur në paragrafin 3 më sipër, përveç nëse të dy palët shprehimisht bien dakort që çdo tarifë mesatare e roaming me shumicë që rezulton nga zbatimi i marreveshjes nuk është objekt i tarifave maksimale me shumicë për periudhën e vlefshëmrisë së marrvëeshjes.”

N°	Draft Vendimi i ARKEP	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
	me shumicë për perioudhën e vlefshëmrisë së marrvëshjes.”		
6	Paragrafi 3, pika e):	Spo kuptohet? te riformulohet nese eshte e mundur.	Ky paragraf eshte bazuar ne nenin 3 te Rregullores se Roamingu te BE nr.531/202 te ndryhuar me Rregulloren nr.2017/920 dhe gjithashtu eshte e sqaruar ne menyre me te detajuar edhe ne udhezuesit e BEREC-ut.
7	Paragrafi 4:  Tarifat maksimale me shumicë të Roamingut që operatorët e rrjeteve mobile në Republikën e Kosovës, në rolin e operatorit të rrjetit të vizituar, mund të aplikojnë ndaj operatorëve të rrjeteve mobile nga Republika e Shqipërisë për ofrimin e shërbimit të rregulluar të thirrjeve të origjinuara në rrjetin e vizituar, përfshirë midis të tjerave kostot e <i>origjinimit, tranzitimit dhe terminimit, ...</i>	Mungon destinacioni i thirrjeve, per te cilen vlene tarifa. duhet te jete Kosova dhe Shqiperia, ne analogji me rregullativen ne eu.  A eshte kolona 3te MTR? qysh perfshihet ketu, apo diku tjeter, tranzitimi?	Marreveshja ka te beje vetem me thirrjet dhe SMS ne mes Republikes se Kosoves dhe Shqiperise.  Kolona e trete ka specifikuar tarifen maksimale te terminimit mobil (MTR) per thirrjet ne roaming te origjinuara dhe terminuara ne mes KS dhe AL. Kjo tarife gjithashtu perfshine edhe transitimin.  Per te qene ne perputhje edhe me marrveshjen rajonale te roamingut termi “tarife maksimale” eshte zevendesuar me “tarife mesatare maksimale” dhe jane shtuar edhe paragrafet me sqarimet perkatese.
8	Paragrafi 7:	Cfare eshte menduar? cilat karakteristika mund te ndryshojne varesisht ku zbatohen, home v roaming?	SMS duhet te tarifohet per SMS ne nivelin me shumice dhe pkice. Bazuar ne nenin 11 te Rregullores se BE nr.531/2012 nje SMS ne

N°	Draft Vendimi i ARKEP	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
			roaming duhet te kete te parametra teknik te njejte sikurse me SMS ne nivel vendi. Nje SMS perfshine deri 160 karaktere.
9	Tabela 1 dhe 2	Njejte sikur te tab 1 w/s, mungon destinacioni moc	Shih pergjigjet me larte
10	Paragrafi 10:	Cka eshte menduar ketu: thirrja drejt voicemail eshte moc-roaming, me kosto te caktuar mbrapa, rrjedhimisht, mos aplikimi i tarifese shtese eshte i pa justifikueshem, ne kete kontekst. Te ri-shihet dhe te precizohet mundesisht.	Rregullora e BE e Roamingut i ndalon aplikimin e tarifave per mesazhet zanore (voicemail) te depozituara ne kutine postare (mailbox) te rrjetit te parapaguesit ne roaming te derguar nga nje telefonues tjetet.  Kjo nuk perfshine thirrjen drejt voicemail. Pra pranimi i voicemail është pa pagesë, ndërsa dëgjimi mund të jetë objekt i tarifimit nga operatori.
11	SHTOJCA, Transparenca për tarifat me pakicë për thirrjet dhe SMS në roaming Pika 1, paragrafi 3	Numer falas kur ka nje kosto, per thirrje ne roaming? Te precizohet nese fjala eshte per thirrje ne home network, jo ne roaming.	Bazuar ne nenin 14 te Rregullores e Roamingut te BE, operatoret duhet te ofrojne mundesine e qasjes ne sherbimet emergjente duke telefonuar pa pagese ne numrin 112 dhe numrin falas per informta te hollesishme per konsumatorin, kur ai kyqet per here te pare ne nje rrjet tjetet nga ai i ofruesit te tyre te sherbimit.
12	SHTOJCA, Transparenca për tarifat me pakicë për thirrjet dhe SMS në roaming Pika 1, paragrafi 4	Pa pagese? njejte si me sipër, kur ka nje kosto roaming veshtire te sigurohet mekanizem pa pagese. pervec nese eshte menduar qe mekanizmi te thirret ne rrjetin home. kerkohet precizim.	Shih me larte
13	SHTOJCA, Transparenca për tarifat me	Te hiqet mundesisht, teper ambicioze. Nuk kemi praktikuar nje menyre te tille informacioni as ne rrejtin	Ndryshohet ky paragraf si ne vijim:

N°	Draft Vendimi i ARKEP	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
	pakicë për thirrjet dhe SMS në roaming Pika 1, paragrafi 5	home.	MNO inkurajohet t'u ofrojë parapaguesëve të verbër ose me shikim të pjesshëm informacionin bazë tarifor të personalizuar të përmendur në nënparagrafin e parë automatikisht, me thirrje zanore, pa pagesë, nëse parapaguesi e kërkon këtë shërbim.
14	SHTOJCA, Transparenca për tarifatat me pakicë për thirrjet dhe SMS në roaming Pika 2	Spo kuptohet, rrjeti i vizituar ne kosove ka te beje me inbound. shih mos eshte typo, duhet te jete Shqiperi ne vend se Kosove.	Ndryshohet ky paragraf si ne vijim:  “Përveç përcaktimeve të paragrafit 1, parapaguesit kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin informacion tarifor më të detajuar dhe të personalizuar për tarifatat e roamingut që aplikohen në rrjetin e vizituar në Shqipëri për ...”
15	SHTOJCA, Transparenca për tarifatat me pakicë për thirrjet dhe SMS në roaming Pika 2a	Niveli prag i përdorimit. Si është e mundur të realizohet për moc? i vetmi burim i informacionit për të matur vëllimin dhe, rrjedhimisht, për nisur informacion për tejklimin e pragut është rrjedha e fileve TAP. Kur vonesat TAP ndodhin, është e pamundur njoftimi në kohe. cilat janë praktikatat në Evropë?  Falas, sic u tha, ka kuptim vetëm në rrjetin home. kërkohej precizim në këtë aspekt.	Ndryshohet ky paragraf si ne vijim:  “ <b>Ne përputhje me nenin 13 të Rregullores nr.38</b> MNO duhet të dërgojë një njoftim për parapaguesin roaming kur sasia e përdorimit të drejtë të thirrjeve zanore ose SMS roaming të rregulluara, është konsumuar plotësisht ose kur arrihet niveli prag i përdorimit i aplikuar....”
	SHTOJCA, Transparenca dhe mekanizma mbrojtës për shërbimet me pakicë roaming për të dhënat Pika 2, paragrafi 3	Mundësitë që mesazhi informues të shkojë kur inicohet sesioni i pare data, është i pamundur aktualisht? vlerësohet kërkesa e tepruar, kur monitorimi dhe njoftimi për nivele të ndryshme përdorimi është i aplikueshem. të ri-shikohet mundësisht.	Kjo është e specifikuar në rregulloren e BE neni 15, paragrafi 3. BEREC konsideron se konsumatorëve duhet t'i ofrohet menyrë për maksimizimin e shanceve të tyre për pranimin e notifikimeve dhe të jenë në gjendje që të reagojnë për të vazhduar me përdorimin e të dhënave edhe pas kalimit të

N°	Draft Vendimi i ARKEP	Komentet e Telekomit të Kosovës sh.a.	Përgjigja e ARKEP
			limitit.
	SHTOJCA, Transparenca dhe mekanizma mbrojtës për shërbimet me pakicë roaming për të dhënat Pika 3, paragrafi 7	Interaksioni me parapaguesin ne roaming eshte i pamundshem aktualisht. ti rishikohet dhe hiqet si kerkese ultimative, mundesisht.	Shih me larte
	SHTOJCA, Transparenca dhe mekanizma mbrojtës për shërbimet me pakicë roaming për të dhënat Pika 6	Pse vetem gjate periudhes RLAH+? mos aludon qe RLAH perfundimisht eliminon pakot me sasi te kufizuara?	Ky paragraf eshte bazuar ne Rregulloren e BE-se per Roaming dhe udhëzuesit e BEREC.
	SHTOJCA, Transparenca dhe mekanizma mbrojtës për shërbimet me pakicë roaming për të dhënat Pika 7	Si eshte menduar: ne mungese te cfare?	Ky paragraf eshte bazuar ne Rregulloren e BE-se per Roaming dhe udhëzuesit e BEREC.



N°	Draft Vendimi i ARKEP	Komentet e IPKO	Përgjigja e ARKEP
1	Koment i përgjithshëm	<p><b>Komentet e përgjithshme</b></p> <p>Para se të lëshohemi në komentimin e neneve përkatëse, do të donim që të komentoni në çështje që rregullorja nuk i ka përmendur/rregulluar, për të cilat ne konsiderojmë që duhet të përfshihen, si në vijim:</p> <p><b>- Përfshirja e pakove ekzistuese të operatorëve nga ky vendim</b></p> <p>Konsiderojmë që vendimi duhet shprehimisht të qartësoj që pakot ekzistuese të operatorëve nuk janë objekt i këtij vendimi dhe që operatorët duhet të krijojnë pako të reja, që do të jenë në fuqi nga data e hyrjes në fuqi e të njëjtit dhe do të jenë në përputhje me këtë vendim. Modifikimet nuk mund të jenë të zbatueshme për pakot ekzistuese, sepse teknikisht është e pamundur të modifikohen mbi 150 pako ekzistuese si dhe kontrata të veçanta për klientët e biznesit, pako të cilat në bazë të kërkesës së tyre janë përshtatur.</p> <p>Në rast se ARKEP vendos që megjithatë ky vendim të jetë i aplikueshëm edhe për pakot ekzistuese, atëherë, operatorët duhet të kenë një afat 1 vjeçar në dispozicion. Kjo për shkak të kompleksitetit të këtij ndryshimi, si dhe faktit që IPKO është në proces të implementimit të kodit kombëtar 383, dhe deri më 1 korrik e ka tërë resurset humane të angazhuara në këtë projekt më rëndësi kombëtare.</p> <p><b>- Rregullimi i thirrjeve vetëm brenda Shqipërisë dhe</b></p>	Ky vendim është në përputhje të plotë me Rregulloren e BE dhe udhëzuesit e BEREC.

N°	Draft Vendimi i ARKEP	Komentet e IPKO	Përgjigja e ARKEP
		<p><b>Kosovës</b></p> <p>Në mënyrë që t'i ikim paqartësive, është mirë që vendimi te specifikoj ne mënyrë të qartë që thirrjet me pakicë në vendet e tjera te roaming nuk janë të rregulluara. Marrëveshja është e zbatueshme vetëm për thirrjet brenda destinacioneve Kosove-Shqipëri</p>	
2	<p><b>Paragrafi 3):</b></p> <p>Nga data 15 Qershor 2019 ofruesit e shërbimeve të telefonisë mobile në Republikën e Kosovës duhet të përmbushin të gjitha kërkesat e arsyeshme për qasje me shumicë në roaming nga operatorët, të cilët operojnë në Republikën e Shqipërisë.</p>	<p>Zbatimi i projektit RLAH + kërkon modifikime mbi sistemet e njëjta ku po aplikojmë modifikime për projektin Country Code. Duke marrë parasysh kompleksitetin dhe ashpërsinë e të dy projekteve që i drejtojnë ato paralelisht, do të kishin këto rreziqe:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ne mund të mos jemi në gjendje të përfundojmë ndonjë prej tyre në kohë, sepse kemi resurse humane të kufizuara dhe shumica e tyre tashmë janë të angazhuar në Projektin e Kodit Shtetëror. Caktimi i resurseve humane të njëjta në dy projekte kritike paralelisht do të krijonte konfuzion tek zhvilluesit, rrjedhimisht do të reduktonte efikasitetin e tyre dhe do të rriste rrezikun për implementimin e duhur dhe me cilësi.</li> <li>- Në rast të identifikimit të ndonjë problem teknik, do të jetë mjaft e vështirë të përcaktohet nëse çështja është shkaktuar për shkak të modifikimeve në një apo tjetrën projekt. Këto janë projekte masive duke përfshirë modifikime në një numër të madh të sistemeve;</li> <li>- sistemet janë të strukturuar në atë mënyrë që në rast të zhvillimeve paralele mbi të njëjtin çështje, nisja e të dy projekteve duhet të sinkronizohet. Kjo do të thotë që projektet e Kodit të shtetëror dhe Roaming AL-KS duhet të lëshohen së bashku në të njëjtën kohë. Kjo nuk është e</li> </ul>	<p>Neni 1 i Marrëveshjes ka përcaktuar datën 15 Qershor 2019 për fillimin e zbatimit të regimit të ri të roamingut dhe si rrjedhojë, kjo datë është e detyrueshme.</p>

N°	Draft Vendimi i ARKEP	Komentet e IPKO	Përgjigja e ARKEP
		mundur për shkak të shpjegimeve të mësipërme. Bazuar në arsyetimet e mësipërme dhe duke marrë parasysh se deri në fund të qershorit burimet tona do të përfshihen në implementimin dhe monitorimin e projektit të Kodit Shtetëror, ne propozojmë si kohë fillestare për zbatimin e këtij projekti më <b>1 shtator 2019</b> .	
3	<p><b>Paragrafi 3), pika a):</b> Nga data 15 Qershor 2019 ofruesit e shërbimeve të telefonisë mobile në Republikën e Kosovës duhet të përmbushin të gjitha kërkesat e arsyeshme për qasje me shumicë në roaming nga operatorët, të cilët operojnë në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>a) Ofruesit e shërbimeve të telefonisë mobile obligohen që të përgatisin ofertën referente dhe t'a vënë në dispozicion për operatorët nga Republika e Shqipërisë...</p>	<p>Afati i fundit për publikimin e ofertës referuese të jetë se paku 3 muaj pas fillimit të implementimit të marrëveshjes, se paku 3 muaj, marrë parasysh komentet lidhur me implementimin e kodit kombëtar të përshkruara më lartë.</p>	<p>Paragrafi në fjale nuk ka përcaktuar ndonjë afat për publikimin e ofertës referente. Sidoqoftë paragrafi 3 specifikon se qasja duhet të jepet jo më vonë se 3 muaj pas kërkesës.</p> <p>Për të qenë në përputhje me marrëveshjen rajonale të roamingut, fshihen nenparagrafet a), b), d) dhe e) të paragrafit 3 dhe shtohet paragrafi që ka të bëjë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.</p>
4	<p><b>Paragrafi 12):</b></p> <p>Ofruesit e shërbimeve të telefonisë mobile mund të aplikojnë një "Politikë të përdorimit të drejtë" (Fair use policy) për shfrytëzimin e shërbimeve të rregulluara të Roamingut me</p>	<p>Te specifikikohet qartë se operatorët janë të lirë të përcaktojnë politikën e tyre të përdorimit të drejtë në mënyrë specifike për çdo shërbim roaming. Kjo sepse në EU tashmë praktikohet kjo dhe do t'i jepte Propozimi jonë do të ishte:</p> <p><i>Ofruesit e shërbimeve të telefonisë mobile mund të aplikojnë dhe janë të lirë që të përcaktojnë sipas vlerësimit të tyre një "Politikë të përdorimit të drejtë" (Fair use policy) për shfrytëzimin e</i></p>	<p>Marreveshja rajonale ka parapare hartimin e dokumentit Fair Use Policy, i cili duhet të jetë i njëjti në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe në përputhje me ato të BE-se.</p>

N°	Draft Vendimi i ARKEP	Komentet e IPKO	Përgjigja e ARKEP
	<p>pakicë në raport me çmimet e shitjes me pakicë të aplikuara në nivel kombëtar, me qëllim që të parandalojnë përdorimin abuziv ose jo normal të shërbimeve të Roamingut me pakicë nga parapaguesit, siç janë: përdorimi permanent i shërbimeve të Roamingut, modifikimi i CLI, etj.</p>	<p><i>shërbimeve të rregulluara të Roamingut me pakicë në raport me çmimet e shitjes me pakicë të aplikuara në nivel kombëtar..</i></p>	